

THIRRRJE TË GJITHAVE

TË MËKURËN 14 QËRSHOR 2023

***GREVË
FEMINISTE***



Në Zvicër si në shumë vende, kemi demonstruar për barazinë, kunder seksizmit dhe kundër diskriminimeve. Pas grevës historike të 14 qërshorit 2019, shumica e kërkesave tona kanë mbetur par rezultat. Prandaj, më **14 qërshor 2023, do mbajmë prap grevë !**

Jemi lodhur duke pritur : para 42 vite populli zvicëran ka votuar për ta shkruar barazinë gjinore në kushtetutë. Por rrogat dhe pensionet tona janë duke u ulur, dhe janë shpeshherë mjeruese. Arsya pse ne punojmë gjysëm orari, është se ne i marrim përsipër dy të tretat e punës shtëpiake, edukative dhe kujdestare në rrethet tona : pastrimi, gatimi, larja e rrobave, fëmijët, nipat dhe mbesat, të afërmit të sëmurë ose të moshuar. Puna jonë, pa të cilën shteti nuk do mund të funksiononte, jo vetëm që është e papaguar, por edhe prodhon pasuri. Kjo punë duhet të vlerësohet.

Jemi lodhur nga seksizmi dhe nga të gjitha dhunat. Ne duamë të jetojmë pa frikën që mund të agresohejmë, që mund të kërcënohejmë në punë, që mund të keqtrajtohejmë në shtëpi. Për ti respektuar jetat tona, trupat tonë, është e domosdoshme që të eliminohen dhunat ndaj grave dhe ndaj personave LGBT, dhe të mirënjohet e drejta jonë për të vendosur për vete.

Ne duamë që shoqëria jonë të themelohet në barazi, solidaritet. Shoqërinë tonë e duamë pa diskriminime, pa seksizëm dhe pa dhuna kundër grave dhe personave LGBT, çfarëdo çoftë ngjyra e lëkurës, kultura, origjina, feja, pasaporta, orientimi seksual, identiteti gjinor, mosha ose statuti.

Prandaj, më 14 qërshor 2023, Do mbajmë grevë.

Greva do të jetë e përgjithshme : në punë si në shtëpi. Do ti përshtatet mundësive të secilës : mund ti mbajmë krahët kryq për një moment ose gjatë gjithë ditës, të krijojmë mosrregullsi në punat shtëpiake, të marrim pjesë në demonstrata në vende publike gjatë ditës ose në mbrëmje ! Greva jonë nuk do të jetë kundër burrave, por kundër një sistem patriarkal që i përket kohës së kaluar. Më 14 shkurt 2023, burrat solidarë do të ftohen për të na mbështetur.

Kontakti grupin e rajonit tuaj

info@gregefeministe-vd.ch

gregefeministe.riviera@gmail.com

gregefeministe.nyon@gmail.com

gregefeministe.renens@gmail.com

@gregefeministevaud



Grève Féministe Vaud



www.gregefeministe-vd.ch